



Buletini mujor

Prill 2026



KLSH dorëzon në Kuvend Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2025

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka dorëzuar në Kuvend Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2025, një dokument kyç që përmbledh rezultatet kryesore të aktivitetit auditues dhe veprimtarisë së institucionit.

Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, KLSH gjatë vitit 2025 ka zhvilluar 190 misione auditimi në institucionet publike. Këto misione kanë përfshirë 44 auditime të përputhshmërisë, 63 auditime financiare, 32 auditime të kombinuara, 13 auditime tematike, 13 auditime performance, 10 auditime të sistemeve të teknologjisë së informacionit, si dhe 15 auditime për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve. Auditimet janë kryer në 271 subjekte, nga të cilat: 126 subjekte të qeverisjes qendrore, 87 të vetëqeverisjes vendore, 13 institucione të administrimit të pronës publike dhe 45 shoqëri publike me aksioner shtetin mbi 50%.

Në auditimet e ushtruara gjatë vitit 2025 janë dhënë 222 opinione/mesazhe dhe konkluzione auditimi. Rezultatet e auditimeve janë shoqëruar me 4994 rekomandime, të cilat përfshijnë: 29 propozime për përmirësime të kuadrit ligjor, 3268 masa organizative, 281 masa për shpërbllim dëmi, 441 masa për adresimin e parregullsive me efekt negativ financiar dhe 975 masa disiplinore dhe administrative. Këto masa kanë synuar adresimin e problematikave të konstatuara, forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe rritjen e përgjegjshmërisë institucionale, me qëlim

përmirësimin e administrimit të fondeve publike, në funksion të shmangies së përsëritjes së tyre në të ardhmen.

Në përputhje me detyrimin ligjor dhe si një tregues thelbësor i efektivitetit dhe ndikimit të veprimtarisë audituese, KLSH kryen në mënyrë të vazhdueshme auditime për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Ky proces synon të vlerësojë nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga institucionet e audituara, si dhe të sigurojë ndjekjen e masave të marra për adresimin e tyre.

Gjatë vitit 2025 është verifikuar zbatimi i 4348 rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. Rreth 99% e rekomandimeve të lëna janë pranuar, nga të cilat, 70% janë zbatuar plotësisht, pjesërisht, ose janë në proces zbatimi nga institucionet përkatëse.

Ky tregues, pavarësisht nivelit të lartë të pranueshmërisë së rekomandimeve nga institucionet publike, evidenton nevojën për përmirësimin e mëtejshëm të nivelit të zbatimit të tyre në praktikë.

Në këtë kuadër, KLSH ka vijuar të ndjekë zbatimin e rekomandimeve në subjektet e audituara, duke kërkuar marrjen e masave konkrete për zbatimin e plotë dhe në kohë të tyre, si një mekanizëm kyç për sigurimin e ndjekjes efektive të rekomandimeve dhe për përmirësimin e performancës së institucioneve të audituara.

RAPORTI I PERFORMANCËS 2025

TREGUESIT KRYESORË

Auditime

190

Gjatë vitit 2025, KLSH ka kryer 190 auditime nga 180 të programuara, si auditime: përputhshmërie, financiare, të kombinuara, performance, të teknologjisë dhe informacionit, tematike për çështje të veçanta dhe për zbatimin e rekomandimeve.



Subjekte të audituara

271

Në përputhje me mandatin ligjor, KLSH ka kryer auditime në institucione të pavarura, të qeverisjes qendrore, vetëqeverisjes vendore, shoqëri publike me kapital shtetëror mbi 50% dhe auditime të investimeve me financim të huaj.



Opinione/konkluzione

222

Bazuar në evidencën e auditimit dhe gjykimin profesional të audituesit, në vlerësim të kriterëve të auditimit, materialitetit të gjetjeve dhe përhapjes së tyre, është konkluduar respektivisht me opinione/mesazhe/konkluzione auditimi.



Rekomandime

4994

Për mangësitë, parregullsitë dhe problematikat e identifikuara në auditime janë dhënë 4994 rekomandime për përmirësimin e situatës, të cilat përfshijnë masa organizative, disiplinore, administrative dhe përmirësime ligjore.



Zbatueshmëria e rekomandimeve

70%

Në përmbushje të detyrimit ligjor, KLSH ka ushtruar auditime mbi zbatimin e 4348 rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, me qëllim verifikimin e statusit të tyre dhe ndjekjen e masave të marra nga institucionet.



ZBATIMI I REKOMANDIMEVE



125

Auditime të verifikuara për zbatimin e rekomandimeve

- 43 Auditime të kombinuara
- 37 Auditime financiare
- 24 Auditime përputhshmërie
- 13 Auditime performance
- 6 Auditime tematike
- 2 Auditime IT

4348


Rekomandime të lëna për zbatim nga subjektet

- 2368 Masa organizative
- 1142 Masa disiplinore
- 717 Efekte financiare
- 76 Masa administrative
- 27 Përmirësime ligjore


Performanca institucionale nuk mund të arrihet pa konsolidimin e një sistemi efektiv të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve. Kjo është rruga e vetme e përbushjes së qëllimeve strategjike të misionit dhe vizionit institucional, si dhe pritshmërive të Kuvendit, publikut dhe palëve të interesit. Kërkesat e Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI (IFPP) përcaktojnë qartë rolet e përgjegjësitë e subjekteve të audituara dhe Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI), sipas të cilave, është thelbësore që përgjegjësia për implementimin e rekomandimeve në kohë dhe me efektivitet është e subjekteve të audituara; por, nga ana tjetër, është përgjegjësi e SAI-ve ndjekja e zbatimit të rekomandimeve, pra verifikimi nëse veprimet e ndërmarra i shërbejnë rezultateve të pritshme.

Rekomandimet e adresuara përfaqësojnë instrumentet nëpërmjet të cilave auditimi mund të sjellë një vlerë të shtuar për njësitë publike. Efektiviteti i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nga KLSH është thelbësor për arritjen e përfitimeve maksimale nga veprimtaria audituese. Konsolidimi i një mekanizmi efektiv të verifikimit sistematik dhe raportimit të zbatimit të rekomandimeve, bazuar në metodologji dhe procedura të standardizuara, të qarta dhe të mirëdetajuara, i lejon jo vetëm Kontrollit të Lartë të Shtetit, por dhe palëve të treta Kuvendit, Qeverisë etj., të sigurojnë në vijimësi një informacion të plotë lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e subjekteve të audituara për hartimin e dokumenteve strategjike në nivel institucional dhe kombëtar apo për iniciativa për ndryshime ligjore, administrative dhe organizative. Nga verifikimi në terren i zbatimit të rekomandimeve, rezultoi se nga 4348 rekomandime të lëna gjatë vitit 2024, 4294 rekomandime janë pranuar, ose rreth 99% e tyre dhe nuk janë pranuar 54 rekomandime, ose rreth 1%.


Nga 4294 masa të pranuar, 1598 masa rezultuan të jenë zbatuar plotësisht (ose rreth 37% e totalit të masave të pranuar), 645 masa zbatuar pjesërisht (ose rreth 15% e totalit të masave të pranuar), 746 në proces zbatimi (ose rreth 18% e totalit të masave të pranuar) dhe 1305 masa janë ende pa zbatuar (ose rreth 30% e totalit të masave të pranuar).




Pranueshmëria




Zbatueshmëria




Zbatuar plotësisht



Në proces zbatimi



Zbatuar pjesërisht



Pa zbatim

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu merr pjesë në Konferencën për Dialog Kombëtar: Forcimi i ndërveprimit institucional për mbikëqyrje efektive

Në datë 23 prill 2026 u organizua në Tiranë Konferenca për Dialog Kombëtar “Forcimi i ndërveprimit institucional për mbikëqyrje efektive”, nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në kontekstin e bashkëpunimit me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe Agjencinë e Inteligjencës Financiare, në kuadër të projektit MATRA “Për forcimin e mbikëqyrjes publike dhe koordinimit ndërinstucional” me mbështetjen e Ambasadës Holandeze në Tiranë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, falënderoi në mënyrë të veçantë Shkëlqesinë e Tij, Ambasadorin Reinout Vos, për mbështetjen dhe vlerësimin e treguar mbi punën dhe kontributin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, veçanërisht në forcimin e rolit të institucionit përmes bashkëpunimeve me institucione homologe dhe organizata ndërkombëtare të auditimit.



Gjithashtu, z. Shehu, në fjalën e tij theksoi se Kontrolli i Lartë i Shtetit mbetet i angazhuar të kontribuojë me profesionalizëm, pavarësi dhe frymë bashkëpunimi në çdo nismë që synon rritjen e transparencës, përdorimin me përgjegjësi të fondeve publike si dhe forcimin e mekanizmave të llogaridhënies, në funksion të rritjes së besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike dhe përmirësimit të mirëqeverisjes në vend. Konferenca trajtoi ndër të tjera rolin e aktorëve shtetërorë dhe profesioneve të lira për të nxitur një qasje të integruar dhe bashkëpunuese drejt ndërveprimit mes tyre për promovimin e transparencës, integritetit dhe një sistemi më efektiv të mbikëqyrjes në vend.

Trajnimi mbi monitorimin e “Planeve të Integritetit”

Më 24 prill 2026 auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit morën pjesë në trajnimin e zhvilluar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), i fokusuar në rolin kyç të institucioneve të pavarura në monitorimin e zbatimit të “Planeve të Integritetit”.

Trajnimi, i udhëhequr nga eksperti Alain Hoekstra, synoi forcimin e kuadrit konceptual mbi etikën dhe integritetin, si dhe prezantimin e praktikave më të mira evropiane. Përvoja holandeze demonstroi një model të avancuar, ku auditimet e integritetit raportohen si produkte të pavarura drejtpërdrejt në Parlament, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien.

Ky zhvillim përbën një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe të matshëm për monitorimin e zbatimit të “Planeve të Integritetit”, duke kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e mekanizmave për parandalimin e rreziqeve të korrupsionit.

Në kuadër të bashkëpunimit dhe me mbështetjen e Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) gjatë viteve 2021–2025, IDM dhe KLSH zhvilluan një metodologji të dedikuar për vlerësimin e “Planeve të Integritetit”.

Aktiviteti u zhvillua në kuadër të projektit “GoEthics 2.0 – Governance, Ethics & Integrity” me mbështetjen e Ambasadës së Suedisë në Tiranë.





KLSH paraqet te Nënkomisioni për Auditimin e Sektorit Publik gjetjet e auditimit “Efektiviteti dhe siguria e barnave që qarkullojnë në Shqipëri”

Kontrolli i Lartë i Shtetit paraqiti në mbledhjen e datës 21.04.2026 të Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik raportin e auditimit të performancës “Efektiviteti dhe siguria e barnave që qarkullojnë në Shqipëri”. Prezantimi i auditimit, i cili mbulon periudhën 2020-2023 u bë nga znj. Arminda Bushi, përgjegjëse e grupit të auditimit dhe drejtuese e Departamentit të Auditimit të Performancës në KLSH.

Znj. Bushi theksoi se auditimi trajton çështje që lidhen drejtpërdrejt me jetën dhe shëndetin e qytetarëve, siç janë barnat që qarkullojnë në Shqipëri, duke ngritur pyetjen: nëse janë të sigurta, cilësore dhe të kontrolluara nga institucionet përgjegjëse?

Nga auditimi ka rezultuar se sistemi i kontrollit për sigurinë dhe cilësinë e barnave nuk funksionon në mënyrë të plotë dhe efektive, pasi evidentohen mangësi të rëndësishme në kuadrin ligjor, në mekanizmat e kontrollit dhe në bashkëpunimin ndërinstytucional, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në nivelin e sigurisë së barnave dhe në mbrojtjen e shëndetit publik. “Problemi nuk qëndron te një hallkë e vetme, por te disa hallka të lidhura me njëra-tjetrën, si: kuadri ligjor jo i plotë dhe jo i përditësuar, analiza laboratorike të pamjaftueshme, inspektime të cilat nuk mbulojnë të gjithë sektorin, farmakovigjilenca nuk është sa duhet aktive, ndërsa bashkëpunimi ndërmjet institucioneve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare nuk është në nivelin që kërkon siguria e barnave”, tha në prezantimin e saj znj. Bushi.

Drejtuesi i Nënkomisionit, z. Igli Cara, duke vlerësuar rëndësinë e çështjeve të trajtuara në këtë auditim, bëri të ditur se në mbledhjet e ardhshme do të zhvillohet seancë dëgjimore edhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS) dhe Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) për problematikat e konstatuara në këtë auditim dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Gjatë mbledhjes, audituesit e KLSH-së iu përgjigjën edhe pyetjeve të anëtarëve të Nënkomisionit, lidhur me vendet nga ku importohen barnat në Shqipëri.

Znj. Xhulieta Çelaj, kryeaudituese në Departamentin e Auditimit të Performancës në KLSH, tha se për periudhën 2020-2023 janë importuar nga Evropa rreth 71.5% e totalit të barnave, nga Turqia rreth 14.2%, nga SHBA 5.1%, nga Ballkani janë importuar 4.7%. Ndërkohë, një pjesë e barnave janë importuar nga vende të treta, si: India dhe Korea e Jugut, të cilat përbëjnë 2.3% të totalit; Mbretëria e Bashkuar 2% dhe Kanadaja 0.2%.

Bazuar në problematikat e konstatuara në auditim, KLSH ka rekomanduar 35 masa organizative që MSHMS dhe AKBPM duhet të ndërmarrin për forcimin e sistemit të garantimit të cilësisë dhe sigurisë së barnave me fokus në përmirësimin e kuadrit ligjor, fuqizimin e kontrollit laboratorik, rritjen e transparencës, forcimin e inspektimeve, farmakovigjilencës etj.

Mesazhi i auditimit

“Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore duhet të vijojnë punën për ndërtimin e një sistemi më të fortë dhe më të besueshëm për cilësinë dhe sigurinë e barnave. Kjo nënkupton jo vetëm ndryshime ligjore, por edhe rritje reale të kontrollit, përdorim të teknologjisë moderne, investime në laborator, trajnime për personelin, bashkëpunim më të mirë ndërmjet institucioneve dhe informim më të gjerë të qytetarëve dhe profesionistëve të shëndetësisë. Pra, nga evidentimi i problematikave që dolën nga auditimi, rekomandohet që, për përmirësimin e tyre, sistemi shëndetësor për cilësinë dhe sigurinë e barnave duhet të kalojë nga një funksionim pjesor dhe administrativ në një sistem aktiv mbrojtës për qytetarin.”



KLSH mirëpret Konferencën e 7-të Ndërkombëtare të Audituesve të Rinj – Young EUROSAI (YES)

“Auditues të përgatitur për të ardhmen: Nxitës të ndryshimit në një botë digjitale dhe të qëndrueshme.”

Kontrolli i Lartë i Shtetit do të mirëpresë në datat 9-10 qershor 2026, edicionin e 7-të të Konferencës Young EUROSAI (YES), e cila organizohet në bashkëpunim me Organizatën Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI).

Tema e këtij viti është: “*Auditues të përgatitur për të ardhmen: Nxitës të ndryshimit në një botë digjitale dhe të qëndrueshme.*”

Në një mjedis global që zhvillohet me shpejtësi përmes transformimit digjital dhe, duke vënë theksin te qëndrueshmëria, audituesit duhet ta përçojnë rolin e tyre përtej funksionit parësor.

Audituesit e përgatitur për të ardhmen duhet të veprojnë si nxitës të ndryshimit, duke shfrytëzuar teknologji të përparuara dhe bazuar në të dhëna që mbështesin transparencën, llogaridhënien dhe krijimin e vlerave në perspektivë afatgjatë.

Projekti YES EUROSAI, përmes konferencave që organizohen çdo 2 vjet, hulumton se si profesionistët e rinj mund të bashkëpunojnë për të ndihmuar Institucionet Supreme të Auditimit të rritin dhe forcojnë ndikimin e tyre, si dhe përfitimet e bashkëpunimit të ndërsjellë në komunitetin e audituesve të rinj.

Auditues të rinj që përfaqësojnë Institucione Supreme të Auditimit, anëtare të EUROSAI-t, si dhe të ftuar specialë, do të marrin pjesë në Konferencën Young EUROSAI 2026.

Konferenca është një platformë ndërkombëtare për shkëmbim njohurish midis audituesve të rinj deri në 35 vjeç, me qëllim ndarjen e ideve dhe zgjidhjeve për sfidat me të cilat përballen institucionet e auditimit sot dhe në të ardhmen.



Konferenca do të përfshijë gjithashtu aktivitete sociale, ku pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të njihen me kolegët e tyre, ndërsa vizitojnë Tiranën dhe qytete të tjera të Shqipërisë.

Workshop-i mbi “Auditimin e mjedisit dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm”

KLSH mori pjesë në takimin e punës mbi “*Auditimin e mjedisit dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm*” të organizuar nga SIGMA/OECD në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në datat 8-9 prill 2026.

Takimi bëri bashkë përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) nga rajoni dhe më gjerë, ekspertë nga SIGMA, UNDP dhe Gjykata Evropiane e Audituesve, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe përmirësimin e qasjeve të auditimit në përballimin e sfidave të ndryshimeve klimatike. KLSH u përfaqësua në këtë aktivitet nga z. Bajram Lamaj dhe z. Juljan Hysomemaj.

Diskutimet u fokusuan mbi qasjet bashkëkohore në auditimin e mjedisit dhe rolin e SAI-ve në vlerësimin e politikave publike të lidhura me ndryshimet klimatike. Theks i veçantë u vu mbi ndikimin e rreziqeve klimatike në financat publike, si dhe mbi nevojën për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në zbatimin e politikave mjedisore.

Takimi paraqet një hap të rëndësishëm në drejtim të forcimit të kapaciteteve të audituesve dhe thellimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në drejtim të avancimit të auditimit të mjedisit si një segment i rëndësishëm në arritjen e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm.



Takimi i dytë rajonal mbi auditimin e përbashkët “Fuqizimi i rolit të grave në pozita udhëheqëse dhe në marrjen e vendimeve”



U mbajt në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut takimi i dytë rajonal i auditimit të përbashkët “Fuqizimi i rolit të grave në pozita udhëheqëse dhe në marrjen e vendimeve”.

Ky aktivitet u organizua në datat 2 dhe 3 prill 2026 me mbështetjen e UN Women për Evropën dhe Azinë Qendrore, në kuadër të nismave për forcimin e qeverisjes demokratike dhe avancimin e barazisë gjinore.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Kosova në bashkëpunim me UN Women, duke krijuar një platformë të rëndësishme shkëmbimi përvojash.

Grupet e auditimit prezantuan gjetjet paraprake të auditimeve kombëtare, identifikuan çështje të përbashkëta dhe përcaktuan hapat e mëtejshëm për finalizimin e raporteve dhe hartimin e raportit të përbashkët rajonal.

Diskutimet u fokusuan në analizimin e politikave dhe mekanizmave institucionalë për promovimin e përfaqësimit të grave në pozita drejtuese dhe në vendimmarrje, si dhe në identifikimin e mundësive për përmirësim.








“Forcimi i rolit të grave në pozicione udhëheqëse dhe vendimmarrëse nuk është vetëm çështje barazie, por edhe një parakusht për një qeverisje më cilësore dhe më të përgjegjshme. Përmes këtij auditimi paralel, të cilin po e zbatojmë në bashkëpunim me institucionet e auditimit nga rajoni, ne konfirmojmë rëndësinë e veprimit të përbashkët, shkëmbimit të përvojave dhe ndërtimit të kapaciteteve”, - theksoi në fjalën hapëse të takimit Auditori i Përgjithshëm i Zyrës Kombëtare të Auditimit në Maqedoninë e Veriut, z. Maksim Acevski. Auditimi i përbashkët rajonal përfaqëson një mundësi kyçe për të identifikuar nevojat dhe boshllëqet kryesore në fuqizimin e rolit të grave për pozicione udhëheqëse.



Falënderit për leximin!



Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH

 www.klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit
 E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 klsh_org_al
 Rruga “Abdi Toptani” Nr.1 Tiranë	 (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
	 Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00